



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN260920250023

Tiranë, më 27.01.2026

Komisioni 13

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi Juridik:** “PRIMA ENERGY” sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L62205052L

**Adresa e selisë:** Rruga e “Kosovarëve”, Nj. A nr. 6, pallati Dolcka, Kati 1, Tiranë.

**Personi përgjegjës:** Fatjon Hasani

Për të zhvilluar projektin “SHFRYTËZIM I BAZALTEVE”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Objekti “Suka e Kuqe”, Zona Minerare nr.166/2, Mirditë, Qarku Lezhë.

**Të dhëna teknike:**

*Mbështetur në deklaratimet e AKBN-së.*

Lloji i mineralit: Mineral i Bazalteve.

Periudhë 3 vjeçare me një prodhim prej: 35.000 m<sup>3</sup>/vit.

Sipërfaqja për shfrytëzim: 0.016 km<sup>2</sup>

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë teknike të Ministrisë shprehin mendimin si më poshtë: Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon:*

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, nëse do të ketë përdorim të lëndëve plasëse, përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që te kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

*Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet: Aprovim automatik ne heshtje!*

*Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve për këtë aktivitet shprehen:*

- sugjerojmë të kontaktohet me strukturën përgjegjëse për pyjet në bashki sepse për sipërfaqet që forma (kategoria) e përdorimit të sipërfaqes së kërkuar për projektin ndryshon, duhen ndjekur procedurat sipas VKM nr.1374, datë 10.10.2008, i ndryshuar apo VKM nr.888, datë 27.12.2022, si dhe parashtrimet konkrete për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve;
- të ruajë e të mos dëmtojë sipërfaqet që do përdoren për projektin apo sipërfaqet ndihmëse (të cilat duhet të merren me qira);
- të kihen parasysh parashikimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, dhe ligjit 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar;
- të jepet leje vetëm për 3 (tre) vjet, siç e kërkon në aplikim dhe të realizojë rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve, pas përfundimit të projektit.

*Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore shprehet:*

1.Sipërfaqja e zonës së hapur Nr.166/2 për leje minerare shfrytëzimi është  $S = 0.094 \text{ km}^2$

2.Nuk është kryer rehabilitimi i sipërfaqes ekzistuese të shfrytëzuar, pasi aktiviteti mineral i këtij subjekti nuk ka filluar.

3.Zona minerare e sipërpërmendur nuk ka qenë leje kërkim-zbulimi.

Informacioni shoqërohet me planimetri në shkallë 1: 1 0000 ku janë të pasqyruara konturi 1 zones minerare Nr.166/2 ku do të kryhet aktiviteti mineral i shfrytëzimit, me sipërfaqet dhe koordinatat e tyre përkatëse.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se:* Bazuar në dokumentacionin dhe koordinatat në aplikim, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzimi i bazalteve, Zona Minerare nr.166/2”, Objekti: “Suka e Kuqe”, Mirditë, Qarku Lezhë, me zhvillues “PRIMA ENERGY” dhe aplikues “D.E.A. PROJEKT”, me nr. Aplikimi AN280420250030, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet se:* Referuar koordinatave të konturit të sipërfaqes për shfrytëzimin e bazalteve, si edhe trupave ujqorë të publikuara në Gjeoportalin e ASIG, si edhe ndryshimeve që subjekti ka kryer në sipërfaqen e shfrytëzimit, sipas komunikimeve të muajit janar 2025, rezulton, zhvillimi nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore. Ndërkohë, ju bëjmë me dije se, nëse subjekti “Prima Energy” sh.p.k nuk ka një kontratë për furnizimin me ujë apo për shkarkimin në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura, me shoqërinë ujësjellës-kanalizime të zonës, por do të përdorë burimet ujore të tjera, duhet të aplikojë edhe për leje për furnizimin me ujë dhe shkarkimin e ujërave të përdorura, nëpërmjet portalit e-Albania, “Aplikim për përdorim burimi ujor”.

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet se:* Shoqërisë “Prima Energy sh.p.k., ju informojmë se kësaj shoqërie i është dhënë e drejta nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa Nr.7059/1 prot MIE, datë 01.11.2024), për të aplikuar në QKB për pajisje me leje minerare shfrytëzimi me karrierë për grupin e materiale vendëtimore për zonën nr.166/2, objekti i bazaltit “Suka e Kuqe”, fshati Blinisht, Orosh, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në rast të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës shprehet:* Pas shqyrtimit të dosjes së VNM se paraqitur nga Subjekti zhvillues: “PRIMA ENERGY” për veprimtarinë “PER SHFRYTEZIMIN E BAZALTEVE”. me vendodhje në Zona Minerare nr.166/2, Objekti “Suka e Kuqe”, Mirdite, Qarku Lezhë. ARM-Shkodër, Lezhë, Kukës shprehet parimisht dakord, në këto kushte sjellim në vëmendje që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal.

Gjithashtu, sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Mbetjet e gjeneruara gjatë fazës së punimeve duhet të asgjësohen/trajtohen dhe të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar i pajisur me Lejet/Licensat përkatëse.
- Të mbulohen mjetet e transportit që transportojnë mbetjet inerte dhe materialet e tjera të ndërtimit dhe të pastrohen para daljes jashtë kantierit.

- Te mos shkarkohet asnje lloj derdhje te mbetjeve jashte territorit te sheshit te projekti

*Bashkia Lezhë: Aprovim automatik ne heshtje !*

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* U krye në datë 11.09.2025. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Bashkia, Agjencia Rajonale e Mjedisit si dhe Eksperti Mjedisit i cili ka prezantuar projektin, në zbatim të Vendimit nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” të ndryshuar. Në konsultim me publikun te pranishmit nuk shprehen ankesa apo padakortesi .

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 13, datë 26.01.2026, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.15, datë 20.01.2026, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Shoqërisë “Prima Energy sh.p.k i është dhënë e drejta nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa Nr.7059/1 prot MIE, datë 01.11.2024), për të aplikuar në QKB për pajisje me leje minerare shfrytëzimi me karrierë për grupin e materialevendërtimore për zonën nr.166/2, objekti i bazaltit “Suka e Kuqe”, fshati Blinisht, Orosh, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.
- Shkresa Nr.126 prot, datë 06.03.2026, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Mendimin e Drejtorive teknike të Ministrisë së Mjedisit;
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- Mendimin e AMBU-së;
- Mendimin e bashkisë;

## **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.**

4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.

#### **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21 Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22 Mbetjet që gjenerohen nga procesi i punimeve të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

- 4.23 Të bëhet kontrolli i kushteve teknike në mënyre periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve në gaz të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.24 Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i ndryshuar.
- 4.25 Të përdoren automjete të mbuluara (të mbyllura ose të mbuluara me mbulesë të posaçme) për transportin e materialeve të thata.
- 4.26 Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetem brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.
- 4.27 Pas përfundimit të fazës së punimëve, sugjerojmë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të lira dhe krijimin e sipërfaqeve të gjelbërta, përreth objektit.
- 4.28 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.29 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.30 Subjekti të marre masa për rehabilitim e sipërfaqes së shfrytëzuar.**
- 4.31 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.32 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.33 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - **Zhurma dhe Vibracionet**

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	28.07.2026	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	28.07.2026	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	28.07.2026	Çdo 6 muaj

*Tabela e niveleve kufi:*

**- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	28.07.2026	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	28.07.2026	Çdo 6 muaj

**- Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	28.07.2026	Çdo 6 muaj

**- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

**- Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**MINISTRI**

**SOFJAN JAUPAJ**

# Aneksi 1. Harta me Koordinatat

## 1. Anex: Harta me koordinatat

